



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 537
Datë: 15/2/2024

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", mbështetur në Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (në tekstin e mëtejme "UP") dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejme "MPB"), shpallë

NJOFTIM

Për angazhimin e studentëve në punë praktike profesionale

Informata të përgjithshme:

Ministria e Punëve të Brendshme ofron mundësi të angazhimit në praktikë profesionale pa pagesë për studentët e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me qëllim të zbatimit në praktikë të aftësive teorike në fusha të ndryshme profesionale e administrative.

Për këtë qëllim, MPB ofron mundësi angazhimi të gjashtëqind (600) studentëve të UP-së përgjatë një (1) viti, nën kushtet dhe kriteret si në vijim:

- Orari:** **Fleksibil, në koordinimin me menaxherin e linjës;**
- Numri i studentëve:** **Gjashtëqind (600) studentë, respektivisht njëqind e pesëdhjetë (150) studentë në secilin grup, prej të cilëve:**
- Njëqind (100) studentë të Fakultetit Juridik;
 - Tridhjetë (30) studentë të Fakultetit Ekonomik;
 - Dhjetë (10) studentë të programeve të profilit të shkencave kompjuterike (Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike); dhe
 - Dhjetë (10) studentë të fakulteteve të tjera sipas interesimit të studentëve.
- Kohëzgjatja:** **Dymbëdhjetë (12) muaj, respektivisht tre (3) muaj për secilin grup.**

Fusha e realizimit të praktikës profesionale: Studentët do ta kryejnë praktikën profesionale në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe/ose ndonjërin prej agjencive të saj, në fushat: siguri, administratë publike, trajnime në fushën e administratës, edukim dhe trajnime në fushën e sigurisë, menaxhimit të emergjencave - zjarrfikjes dhe shpëtimit etj., varësisht profilit të studimeve të kandidatit, nevojave dhe mundësive që ka MPB.

Në fund të periudhës së angazhimit: Ministria e Punëve të Brendshme bënë vlerësimin e punës së praktikantëve dhe mbështetur në këtë vlerësim, i pajisë studentët me certifikatë për përfundimin me sukses të punës praktike profesionale.

Kriteret për përzgjedhje:

- Përzgjedhja e studentëve për punë praktike profesionale do të bëhet duke marrë parasysh lartësinë e notës mesatare dhe vitin e studimeve të studentit.
- Kandidatët e përzgjedhur duhet të ndjekin së paku vitin e tretë të studimeve themelore - baçelor ose t'i kenë të regjistruara studimet e nivelit master.
- Përzgjedhja e studentëve do të bëhet nga një komision i përbashkët ad hoc i emëruar nga MPB, në përbërje të anëtarëve nga të dy partnerët.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kërkesa;
- Vërtetimi për statusin e studentit;
- Pasqyra e notave; dhe
- CV-ja me të dhënat e kandidatit.

Afati për aplikim: Prej 20.2.2024 deri më 27.2.2024, në orën 16:00.

Kandidatët e interesuar që të jenë pjesë e këtij programi të praktikës profesionale, kërkesën për aplikim duhet ta dorëzojnë në Zyrën e Arkivit Qendror, nr. 18, në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Rr. "Xhorxh Bush", nr. 35, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.



Zyra e Rektorit